

BASHKIA DROPULL
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Autoriteti: Bashkia Dropull.
Adresa: Jorgucat, Gjirokaster
Tel.0035588490804
Email. bashkiadropull@gmail.com

Në zbatim të nenit 8, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “a” dhe pika 1/1.2, shkronja “a” dhe “c”, nenit 27 , pika 2, nenit 54 dhe nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015:”për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 115/2014: “për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit 9693 datë 19.03.2007: “Për fondin kullësor”, i ndryshuar, VKM-në nr. 398 datë 13.05.2020: ”Për transferimin përfundimtar në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike”. dhe të Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016: “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik” si dhe VKB nr . 53 datë 30/09/2025: “për miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.1187 ha në ngastrën nr. 26, të ekonomisë kullësore ”Libohovë”:

NJOFTOJ:

Fillimin e procedurës për dhënie me qira të sipërfaqes kullësore prej 0.1187 ha në ngastrën nr. 26, të Ekonomisë Kullësore “Libohovë”, me emërtimin popullor “ Gryka e Bogazit”, në zonën kadastrale nr. 2931 dhe me indeks harte J-34-5(43-A).

Procedura e ankandit do të jete e hapur.

Qëllimi i përdorimit do të jetë: aktivitet agroturistik

Konkurimi do të zhvillohet ne dt. 18.06.2026 ,ora 11.00 , ne Sallen e Mbledhjeve te Keshillit Bashkiak, Bashkia Dropull

*Cmimi dysheme i fillimit të konkurimit për sipërfaqen prej 0.1187 ha, është 7810.53 lekë në vit. (Shtatë mijë e tetqind e dhjetë pikë pesëdhjetë e tre) lekë/vit, sipas VKM-së nr. 467, datë 31.07.2025: “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kosotje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”.

*Afati i kontratës për dhënie në përdorim të sipërfaqes kullësore 0.1187 ha është 6 – 10 vjet.

*Vlerësimi i konkurentëve do të bëhet sipas këtyre pikave:

a) projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë;

b) planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë;

c) planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;

d) nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë;

e) masën e qirasë për ha/vit 35 pikë

* Personat fizikë dhe juridikë që do të marrin pjesë në konkurrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- a) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- b) ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- d) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- e) të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- g) nivelin e punësimit në veprimtari;
- h) lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar;
- i) çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- j) adresën e subjektit, telefon, email dhe faks.

*Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim, janë:

- a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes; shuma e kërkuar e sigurimit të ofertes duhet të jetë 2% e vlerës së fondit limit duke plotësuar formularin e sigurimit të ofertes. Vlera e qirase X ha vitet e qirase X2%.
- b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.

- Paraqitja e dokumentave do të bëhet deri në datë __18__/_06_/2026, ora __11.00__ në zyrën e protokollit të Bashkisë Dropull dhe konkurimi do të vijojë në sallën e mbledhjeve.

Subjektet e interesuara ose perfaqësuesit me prokurë mund të terheqin dokumentat e konkurimit brenda 7 diteve nga data e shpalljes së njoftimit.

Të gjithë dokumentët duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre, të paraqiten me një zarf të mbyllur në Zyrën e Protokollit të Bashkisë Dropull, para orarit të hapjes së ofertave.

Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rremë e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.